



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:063227

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06099405

**AC-I-24-0602**

**Në ankesën e**

***Paditësve/ankuesve***

**T dhe I B**, nga Prizreni, përfaqësuar nga avokat F F, Prishtinë.

**Kundër**

***E paditura/Ankuesja***

**N.SH KBI "Progres- Lavertaria dhe Blegtoria", Prizren**, e cila është e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Manushe Karaqi gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve të paraqitur kundër Aktvendimi i Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-III-12-1235 të datës 26 korrik 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 29 gusht 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- Ankesa e paditësve refuzohet si e pa bazuar.**
- Vërtetohet Aktvendimi i Shkallës së parë i DHPGJS C-III-12-1235 i datës 26 korrik 2024.**
- Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike:**

Me 09 tetor 2001, paditësit Z B, T B, A B, I B, R B, J Sh, U G, F G, R K, A Th, që të gjithë nga Prizreni, kanë ushtruar padi kundër të paditurës dhe kërkojnë anulimin e kontratës Leg.nr. të dt. .dhjetor .. dhe dorëzimin e paluajtshmerisë të ngastrës kadastrale nr., ZK Prizren. Paditësit kanë pohuar se lidhja e kontratës është bërë pa vullnetin e lirë të palëve kontraktuese por me kërcënim, andaj kontrata e tillë nuk është e vlefshme dhe si e tillë duhet të anulohet.

Me 07 qershor 2012, Gjykata Komunale ne Prizren, me Aktvendimin C.nr.600/01 është shpallur in kompetente në këtë çështje juridike dhe lëndën pas plotfuqishmërisë me Akt përcjellës të dt. 18 korrik 2012, e ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (tutje DHPGJS).

Me 10 prill 2014, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në padi, në të cilën ka pohuar se në tërësi e kundërshton padinë e paditëse duke e konsideruar si të pa bazuar në ligj. Po ashtu AKP-ja ka pohuar se, paditësit nuk kanë prezantuar dëshmi të besueshme se janë trashëgimtar të paraardhësit të tyre. Lidhur me pohimet e paditësve se kontrata është lidhur në mungesë të vullnetit të shitësit, kjo e drejtë e kërkuar sipas AKP-së ka pushuar që moti. AKP i referohet edhe disa rasteve të praktikave të DHPGJS siç janë: SCA-06-0005, SCC-08-0112 dhe SCC-09-0096, ku Dhoma e Posaçme ka shprehur qëndrimin e saj lidhur me anulimin e kontratave në mes personave fizik dhe Organizatës Bujqësore. I ka propozuar Gjykatës që të refuzohet padia e paditësve si e pabazuar në Ligj.

Me 20 qershor 2024, paditësit në DHPGJS kanë bërë propozim për caktimin e masës së sigurisë duke kërkuar që AKP të mos e bëjë shitjen e paluajtshmerisë së ngastrës kadastrale P-., në sipërfaqe prej 3530 m2 te evidentuara si ZK Prizren. Paditësit kanë theksuar se ekziston rreziku që ngastra kadastrale të shitet përmes shitjes së aseteve në likuidim.

Me 23 korrik 2024, e paditura AKP-ja ka parashtruar përgjigje në kërkesën për masën e sigurisë, në të cilën ka pohuar se në tërësi e kundërshton propozimin e

paditësit, duke e konsideruar si të pa bazuar në ligj. Po ashtu AKP-ja ka pohuar se propozimi për masë të sigurisë nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm dhe të bazuar në fakte të argumentuara, se nga mos aprovimi i masës së sigurisë, paditësve do t'i shkaktohet dëm i pariparueshëm dhe i pa kompenzueshëm. AKP-ja ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar në Ligj kërkesa për caktimin e masës së sigurisë.

Me 24 korrik 2024, Shkalla e parë e DHPGJS-së, ka marrë Aktvendimin C-III-12-1235, dhe ka refuzuar si të pa bazuar kërkesa e paditësve për caktimin e masës së sigurimit.

Në arsyetim të vendimit thuhet se pa paragjykuar zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti, gjykata vlerëson se paditësit/propozuesit në këtë fazë të procedurës, nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme që do arsyetonte lëshimin e masës së sigurimit. Për me tepër shkalla e parë ka theksuar se në bazë të shkresave të lëndës vërehet se ngastra kadastrale ka qenë dhe është e evidentuara në emër të NSH-së KBI "Progres Eksport"-Prizren.

Shkalla e parë tutje ka arsyetuar se propozimi i paditësve për caktimin e masës së sigurimit nuk ka mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, prandaj propozimi si e tillë është refuzuar në tërësi si pabazuar.

Me 07 gusht 2024, e paditësit T dhe I B, përmes përfaqësuesit të tyre e dorëzon në DHPGJS një ankesë kundër Aktvendimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së C-III-12-1235, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, ngase Aktvendimi i kundërshtuara është marr në përbërje të parregullt të Gjykatës, pasi që për Aktvendimin me karakter jo meritor duhet të vendos gjyqtari i vetëm e jo kolegji. Gjithashtu konsiderojnë se Kolegji Shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë kushtet e përcaktuara Ligjor për caktimin e masës së sigurimit, meqë paditësit kanë ofruara prova të mjaftueshme për të bërë të besueshme ekzistimin e së drejtës subjektive. Paditësit me ankesë edhe me tutje i referohen ekzistimit të rrezikut për shitjen e ngastrës kadastrale që është objekt shqyrtimit të kësaj çështje. Po ashtu kanë konsideruar se Shkalla e parë është dashur të caktoj edhe seancë dëgjimore që ti vlerësoj për së afërmi pretendimit e paditësve për caktimin e masës së sigurimit. I

ka propozuar Kolegjit të Apelit që të aprovohet ankesa e tyre si e bazuar, të ndryshohet Aktvendimi i kolegjit të shkallës së parë, i Dhomës së Posaçme, dhe ti ndalohet AKP-së tjetërsimi, i paluajtshemrisë.

Me 14 gusht 2024, e paditura ka parashtruar përgjigje në ankesën e paditësve dhe i ka propozuara Kolegjit të Apelit që refuzoj njëjtën si ta pabazuar dhe ta vërtetoj Aktvendimin e Kolegjit të Shkallës së parë të DHPGJS, me arsyetimin se kërkesa për caktimin e masë së sigurimit nuk, nuk ka mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësve është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së parë i DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Në këtë lëndë, Kolegji i Apelit vëren se paditësit/propozuesit kanë bërë propozim për caktimin e masës së sigurisë duke kërkuar nga DHPGJS që AKP-së ti ndalohet shitja e paluajtshmërisë së ngastrës kadastrale P-., në sipërfaqe prej 3530 m<sup>2</sup> e evidentuara si ZK Prizren.

Me 26 korrik 2024, Kolegji i shkallës së parë i DHPGJS-së, ka marrë Aktvendimin C-III-12-1235, me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar, kërkesën e paditësve për caktimin e masës së sigurisë.

Kolegji i Apelit vlerëson se kriteret se kur duhet të lëshohet Masa e Sigurisë përcaktohen në nenin 61.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme: Pala duhet të ofrojë dëshmi të besueshme se do të rezultojë me humbje dhe dëmtim të drejtpërdrejtë dhe të pariparueshëm nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet.

Kërkesa për dëshmi të besueshme duhet ti përmban që të dyja: *fumus boni iuris* (probabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar pre supozimi i bazës së mjaftueshme ligjore), dhe *periculum in mora* (rreziku i dëmtimit i pashmangshëm dhe i pariparueshëm ndaj kësaj të drejte), pasi që humbja dhe dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm mund të ndodhë vetëm nëse ekziston në të vërtetë e drejta e pretenduar (shih jurisprudencën e përhershme të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së: cf., inter alia, ASC-10-0079, ASC-10-0081, ASC-10-0017, ASC-10-0049, ASC-10-0088).

Me fjalë të tjera: Paditësit/Ankuesit të cilët kërkojnë Masë të Sigurisë duhet të dëshmoj probabilitetin se 1) ekziston rreziku i të drejtës të cilën e kërkon, dhe 2) e drejta është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes ose dëmtimit të pariparueshëm, nëse nuk lëshohet Masa e Sigurisë e cila kërkohet.

Kolegji i Apelit siç ka vlerësuar edhe Shkalla e parë e DHPGJS, vlerëson se pa paragjykuar zgjedhjen përfundimtare të këtij kontesti, paditësit në këtë stad të procedurës, me provat e dorëzuar nuk e kanë bërë të besueshme faktin se ekziston e drejta e tyre në objektin e kontestit.

Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë, me të drejtë ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet e depozitës së nenit 61 për caktimin e Masës së Sigurimit, pasi që paditësit nuk ka paraqitur ndonjë rrethanë nga e cila pritet të pësojë ndonjë dëm të menjëhershëm dhe të pariparueshëm, meqë sipas kërkesave ligjore përveç që duhet të behet e besueshme e drejta e pretenduar, duhet që paditësit të dorëzojë dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë dhe në mënyrë të pariparueshme, nëse nuk caktohet kërkesa për masë të sigurimit.

Kolegji i Apelit nuk i mbështet pretendimet e përfaqësuesit të paditësve të parashtruar në Kolegjit të Apelit i cili pretendon se në rastin konkret është dashur të vendos Gjyqtari individual e jo Kolegji në përbërje prej 3 gjyqtarëve. Ky pretendimi i paditësit është i pa bazuar, ngase neni 4 paragrafi 9 ka paraparë që *“Të gjitha lëndët për të cilat Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive, siç është përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji, përveç kërkesave në lidhje me procesin e privatizimit dhe ato pronësore, shqyrtohen dhe gjykohen në shkallë të parë nga një gjyqtar i vetëm. Kërkesat në lidhje me procesin e privatizimit dhe kërkesat pronësore do të shqyrtohen dhe gjykohen në shkallë të parë nga një kolegji i specializuar, i përbërë nga tre (3) gjyqtarë.”* Pra është me se e qartë se për çështje pronësore duhet të vendosë në shkalla të parë Kolegji në përbërje prej 3 gjyqtarëve e jo gjyqtari individual siç pretendon përfaqësuesi i paditësve.

Pretendimi tjetër i përfaqësuesit të paditësve se Shkalla e parë është dashur të mbaj seancë dëgjimore para se ta vendos për këtë masë të sigurimit, është po ashtu i pabazuar. Kjo për arse se dispozita e nenit 61 paragrafi 2 parasheh që *“ Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim lidhur me propozimin për caktimin e masës e sigurimit pa mbajtjen e seancës dëgjimore dhe pasi që pala tjetër të ketë pasur mundësinë për të paraqitur argumentet kundërshtuese me shkrim.”* Andaj Kolegji i Apelit vlerëson se Aktvendimi i Shkalles së parë nuk është i përfshirë në shkelje dispozitave të procedurës siç pretendojnë paditësit, meqë dispozita në fjala si Ligj Special i DHPGJS i lejon Shkalles së parë të vendos për kërkesën e masës së sigurimit pa mbajtur seancë dëgjimore.

Andaj për këto arsye, Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e paditësve si të pa bazuar dhe e vërteton Aktvendimin e ankimuar si të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Ky aktvendim nuk prejjudikon zgjidhjen përfundimtare në meritat e padisë.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

## **Taksat gjyqësore**

Paditësit/Ankuesit e kanë paguara taksat gjyqësore për ankesat e tyre me dt. 13 gusht 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 29 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_